



# KQZ-ja PARAQET KAMERAT VËZHGUESE QË DO TË VENDOSEN NË VENDVOTIME



Komisioni Qendror  
Zgjedhor (KQZ) ka  
paraqitur llojin e kamerave  
vëzhguese që do të  
vendosen në vendvotime  
gjatë procesit të votimit

dhe numërimit në zgjedhjet  
parlamentare të 9 shkurtit.  
Sipas KQZ-së, vendosja e  
kamerave vëzhguese në  
hapësirat brenda  
vendvotimit bëhet me

qëllim të garantimit të  
sigurisë së materialeve  
zgjedhore dhe ruajtjes së  
integritetit të procesit të  
votimit dhe numërimit në  
vendvotim

## OSMANI: SULMET HIBRIDE PËRBËJNË SFIDA REALE PËR STABILITETIN KOMBËTAR



## PRESIDENTI I ASAMBLESE PARLAMENTARE TË KE-së PRET NË TAKIM VEPRIMTARIN SALI BISLIMI, KY I FUNDIT KËRKON MBËSHETJE PËR KOSOVËN



## EDHE SLOVENËT BOJKOTOJNË DYQANET SHKAKU I ÇMIMEVE TË LARTA

## SPORT



## ALKETA RAMA PO JETËSON ËNDRRËN E BABAIT NË FUTBOLL

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@ml.net.mk](mailto:renova@ml.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji  
BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Qëllohet për vdekje burri që dogji Kuranin në Suedi

**STOKHOLM, 30 JANAR** - Burri që pati nxitur protesta të dhunshme pas djegies së librit të shenjtë, Kuranit, është qëlluar për vdekje në Suedi, sipas raportimeve të medieve lokale. Salwan Momika, 38-vjeçar, raportohet të jetë vrarë në një apartament në Sodertalje të Stokholmit, në pasditen e së mërkurës. Ai pati nxitur trazira të mëdha pasi pati djegur kopje të Kuranit jashtë xhamisë qendrore të Stokholmit më 2023. Policia në Stokholm ka thënë përmes një deklarate se pesë persona janë arrestuar pasi

një burrë në të 40-at është qëlluar për vdekje përgjatë natës. Mediet lokale kanë raportuar se Momika ishte kyçur drejtpërdrejt në rrjetet sociale rreth kohës kur është qëlluar. Momika, irakian që ka jetuar në Suedi, është akuzuar në gusht, bashkë me një tjetër person, për “agjitacion kundër një grupi etnik”, në të paktën katër raste, në verën e vitit 2023. Vendimi, që ishte paraparë të bëhej publik të enjten, është shtyrë pasi është konfirmuar se “një prej të

pandehurve ka vdekur”, ka thënë gjykata në Stokholm. Momika ka organizuar disa herë protesta kundër Islamit, dhe kështu pati nxitur protesta në shumë shtete me shumicë myslimane. Qeveria suedeze i pati dhënë leje Momikas për protesta, në të cilat ka djegur librin e shenjtë, me arsyetimin se veprimet e tij janë në linjë me ligjet për liri të shprehjes. Më vonë zyrtarët qeveritarë patën thënë se janë duke shqyrtuar mjete ligjore për moslejim të protestave në të cilat mund të digjen tekste.



## Përplasja e aeroplanit në Uashington



**UASHINGTON, 30 JANAR** - Një aeroplan pasagjerësh me 64 persona në të është përplasur me një helikopter ushtarak dhe për pasojë ka rënë në një lumë në Uashington. Autoritetet kanë bërë me dije se kanë arritur t'i nxjerrin trupat e 27 personave nga lumi Potomak, ndërsa një tjetër prej

helikopterit. Shefi i Departamentit të Zjarrfikësve në Uashington ka thënë se nuk pret të ketë të mbijetuar. Temperaturat është raportuar të jenë tejet të ulëta dhe e gjithë situata po vështirëson përpjekjet për kërkim-shpëtim.

Autoritetet amerikane janë duke hetuar rastin, ndërsa Aeroporti Kombëtar i Uashingtonit, Ronald Reagan, i ka ndalur të gjitha fluturimet.

### Çfarë ndodhi?

Rreth orës 21:00 të së mërkurës, sipas kohës lokale, një aeroplan i kompanisë PSA Airlines, duke operuar si American Airlines 5432, është përplasur me një helikopter të ushtrisë amerikane, teksa i është afruar aeroportit Ronald Reagan, sipas Administratës Federale të Aviacionit. Aeroplani i pasagjerëve, i llojit Bombardier CRJ700, është nisur nga Kansasi. Në të kanë qenë 60 pasagjerë dhe katër anëtarë të bordit, sipas American Airlines. Pentagoni ka thënë se

helikopteri ka qenë i tipit Sikorsky H-60, i cili ishte nisur nga Virxhinia. Tre ushtarë kanë qenë në bord, sipas rrjetit televiziv CBS. Administrata Federale e Aviacionit ka thënë se do ta hetojë incidentin, bashkë me Bordin Kombëtar për Siguri të Transportit. Policia dhe Departamenti i Zjarrfikësve janë duke kërkuar në lumë për të mbijetuarit. Përpjekjet për kërkim-shpëtim mund të shihen nga aeroporti Ronald Reagan, që është afër lumit. Presidenti amerikan Donald Trump ka thënë se është informuar plotësisht për “aksidentin e tmerrshëm” dhe që është duke vëzhguar situatën nga afër. “Zoti i bekoftë shpirtat e tyre!”, ka thënë ai përmes një deklarate. Trumpi i ka falënderuar ekipet

e kërkim-shpëtimimit për punën e bërë. Nënpresidenti J. D. Vance ka bërë thirrje për t'u lutur për ata që janë përfshirë në incident. Sekretari i Mbrojtjes, Pete Hegseth dhe sekretari i Transportit, Sean Duffy, të cilët sapo janë emëruar në pozitat e tyre, kanë thënë se janë duke monitoruar situatën. Shefi i kompanisë American Airlines, Robert Isom, ka shprehur “dhimbje të thellë” për përplasjen. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se është thellësisht e mërzhitur për rrëzimin e aeroplanit dhe ka ngushëlluar familjarët që mund të kenë humbur dikë të afërt si pasojë e incidentit. “Kosova është me ju në këtë periudhë zemërthyesë”, ka thënë ajo në X.

## Ahmed Al-Shaara bëhet president i përkohshëm i Sirisë

Udhëheqësi i rebelëve të Sirisë që rrëzuan presidentin Bashar Al-Assad muajin e kaluar u emërua president i përkohshëm i vendit të mërkurën. Ahmad Al-Sharaa, një rebel dikur i lidhur me Al-Qaidan, është kreu i grupit Hayat Tahrir al-Sham (HTS), i shpallur terrorist nga Shtetet e Bashkuara. Emërimi i tij erdhi pasi ish-kryengritësit anuluan Kushtetutën ekzistuese, duke thënë se një e re do të hartohej së shpejti. Njoftimi u bë nga zëdhënësi për sektorin e ri të operacioneve ushtarake të qeverisë de fakto të Sirisë, kolonel Hassan Abdul Ghani, raportoi agjencia shtetërore e lajmeve SANA. Al-Sharaa pritej të shfaqej në

një fjalim televiziv pas takimit, por nuk e bëri këtë menjëherë dhe mbeti e paqartë nëse do ta bënte. Mekanizmi i saktë, sipas të cilit ai u zgjodh president i përkohshëm, nuk ishte gjithashtu i qartë. Al-Sharaa, i njohur më parë si Abu Mohammed Al-Jolani, udhëhoqi ofensivën e rrufeshme që rrëzoi Asadin në fillim të dhjetorit. Dikur grupi ishte i lidhur me Al-Qaidan, por që atëherë është distancuar dhe në vitet e fundit Al-Sharaa është përpjekur të paraqitet si një kampion i pluralizmit dhe tolerancës dhe ka premtuar t'i mbrojë të drejtat e grave dhe pakicave fetare. Shtetet e Bashkuara kishin vendosur më parë një shpërbtim prej 10 milionë



dollarësh për kapjen e Al-Sharaas, por e anuluan atë muajin e kaluar pasi një delegacion amerikan vizitoi Damaskun dhe u takua me të. Diplomati i lartë amerikanë

për Lindjen e Mesme, Barbara Leaf, tha pas takimit se Al-Sharaa u konsiderua “pragmatik”. Nuk pati asnjë reagim të menjëhershëm nga bota arabe

apo më gjerë për emërimin e Al-Sharaas, gjë që pritej. Vendet perëndimore, megjithëse kanë lëvizur për t'i rivendosur lidhjet me Damaskun pas përmbyesjes së Assadit, janë ende disi të kujdesshëm ndaj sundimtarëve të rinj islamikë të Sirisë. Abdul Ghani, zëdhënësi, njoftoi gjithashtu të mërkurën anulimin e kushtetutës së vendit - të miratuar në vitin 2012, nën sundimin e Asadit - dhe tha se Al-Sharaa do të autorizojë të formonte një këshill të përkohshëm legjislativ derisa të hartohet një Kushtetutë e re. Të gjitha fraksionet e armatosura në vend do të shpërbëhen, tha Abdul Ghani, dhe do të absorbohen në institucionet shtetërore.

# Presidenti i Asamblesë Parlamentare të KE-së pret në takim veprimtarin Sali Bislimi, ky i fundit kërkon mbështetje për Kosovën

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

STRASBURG, 30 JANAR - Veprimtari Sali Bislimi, i cili jeton dhe vepron në Zvicër, aktualisht kryetar i "Zërit Perëndimor të Kosovës", është pritur të enjten në takim nga presidenti i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (PACE), Theodoros Roussopoulos. "Pritje shumë e ngrohtë dhe miqësore nga presidenti i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës në Strasburg, z. Theodoros Roussopoulos. Në cilësinë e kryetarit të 'Zërit Perëndimor të Kosovës' pata kënaqësinë të bëj një rezime për Kosovën e vlerave evropiane, përpjekjet e saj për liri, shtetndërtim dhe anëtarësim në organizatat botërore, me theks të veçantë anëtarësimin e saj në Këshillin e Evropës", ka njoftuar në "Facebook", Sali Bislimi.

Gjatë takimit Bislimi ka kërkuar nga Roussopoulosi përkushtim më serioz dhe më shumë dashuri për Kosovën. Bislimi ka theksuar se BE-ja duhet të na ndihmojë në integrimin tonë pa



kushte, sidomos te pesë vendet evropiane që nuk na kanë njohur ende. "Ne jemi vetë Evropa, rrënjët tona i kemi thellë te Gjergj Kastrioti dhe kodi i Lekë Dukagjinit që na ndihmoi t'u qëndrojmë drejt sfidave që deshën të na lëkundin vlerat tona. BE-ja duhet të na ndihmojë në integrimin tonë pa kushte, për 5 vendet evropiane që nuk na njohin akoma, të bëjnë atë për hir të së ardhmes sonë të përbashkët. Apeloj që të na ndihmoni edhe në mbrojtje të islamit politik i cili vjen nga jashtë që na bëhet hendikep i

rrugës sonë drejt integritit. Më është premtuar se në agjendën e muajit maj Këshilli i Ministrave do të vendosë në favor të Kosovës. BE-ja duhet të jetë më e sinqertë, më transparente dhe të komunikojë në mënyrë vëllazërore me politikën kosovare", ka thënë Bislimi. Ai ka theksuar se në mungesë të politikës parimore janë bërë luftërat. "Ku jam edhe vetë pjesë e saj, i lindur në mal dhe jetë kam bërë me gjarpin e shtëpisë që asnjëherë nuk na ka sulmuar, sepse ishte i shtëpisë, i gjendur edhe pranë kroit ku merrja ujë. Me arushën u takuam. Ajo

kishte lot në sy, edhe unë nga frika, por gjetëm një mirëkuptim pa dëme ndaj njëritjetrit. Ne jemi të një shtëpie. Duhet të ndihmohemi për të ecur bashkë dhe në vlera të civilizimit. Padyshim kishte edhe pakënaqësi për trajtimin e minoriteteve, por urojmë që qeveria e ardhshme të punojë

drejt", është shprehur Bislimi. Ai ka uruar që në zgjedhjet e 9 shkurtit populli të votojë drejt dhe të votojë për demokracinë si shansin e vetëm për të ecur më shpejt në integritet. "Shumë mirënjohës për mikpritjen, z. kryetar Roussopoulos! Do të takohemi përsëri", ka shkruar Bislimi.



## Qorrolli flet për përparimet e rëndësishme në sistemin e drejtësisë, thekson funksionalizimin e Gjykatës Komerciale



PRISHTINË, 30 JANAR - Zëvendësministri i Drejtësisë, Vigan Qorrolli, ka marrë pjesë në debatin e organizuar nga GIZ-i mbi qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit, ku diskutoi mbi arritjet kryesore të Ministrisë së Drejtësisë në reformat ligjore dhe fuqizimin e institucioneve të drejtësisë.

Të pranishëm në këtë debat ishin edhe David Oberhuber, drejtor i GIZ-it në Kosovë, Astrit Hoti nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Burbuqe Kastrati nga Lëvizja FOL, Faton Jashari nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas.

Në fjalën e tij, zëvendësministri Qorrolli theksoi përparimet e rëndësishme në sistemin e

drejtësisë, duke përfshirë funksionalizimin e Gjykatës Komerciale, avancimin e procesit për krijimin e Gjykatës Administrative, si dhe përmirësimin e mekanizmave për drejtësinë tranzicionale përmes Institutit për Krimet e Luftës.

Ai vuri në pah miratimin e Strategjisë për Sundimin e Ligjit 2021-2026 e cila synon ndërtimin e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe efikas, bazuar në katër shtylla kryesore.

Më tutje, zëvendësministri Qorrolli tha se në kuadër të reformave ligjore, Ministria e Drejtësisë ka miratuar Ligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin

dhe Konfiskimin e Pasurisë dhe Paketën Ligjore Anti-korrupsion, duke përfshirë Ligjin për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe Ligjin për Deklarimin e Pasurisë. Po ashtu, janë miratuar mbi 120 akte normative, 19 koncept-dokumente dhe 31 marrëveshje ndërkombëtare.

Në fund, zëvendësministri Qorrolli vlerësoi mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë, përfshirë GIZ-in, për fuqizimin e kapaciteteve institucionale dhe digjitalizimin e sistemit të drejtësisë, duke theksuar rëndësinë e transparencës dhe llogaridhënies për ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe efikas.

## Osmani pranoi letrat kredenciale nga ambasadori jorezident i Jordanisë

PRISHTINË, 30 JANAR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pranuar të enjten letrat kredenciale nga ambasadori i ri jorezident i Jordanisë në Kosovë, Hazem Issam El-Khatib Al-Tamimi. Duke i uruar mirëseardhje dhe suksese në mandatin e tij, Osmani shprehu

mirënjohjen e thellë për mbështetjen e vazhdueshme të Jordanisë ndaj Kosovës dhe marrëdhëniet e shkëlqyera ndërmjet dy vendeve.

Presidentja Osmani theksoi rëndësinë e përkrahjes së Jordanisë për Kosovën në forume ndërkombëtare dhe

vazhdimin e mbështetjes për anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Në takim me ambasadorin Al-Tamimi, presidentja Osmani theksoi nevojën për shtimin e dialogut politik dhe bashkëpunimin në fushën e sigurisë, si dhe për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit

në fusha të ndryshme të interesit të përbashkët. Gjatë takimit u diskutua edhe për vizitën zyrtare të presidentes Osmani në Jordani, bazuar në ftesën nga Mbreti Abdullah II, me qëllim që të thellohen edhe më tej raportet e shkëlqyeshme ndërmjet dy vendeve tona.





# KQZ-ja paraqet kamerat vëzhguuese që do të vendosen në vendvotime

Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) ka paraqitur llojin e kamerave vëzhguuese që do të vendosen në vendvotime gjatë procesit të votimit dhe numërimit në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit. Sipas KQZ-së, vendosja e kamerave vëzhguuese në hapësirat brenda vendvotimit bëhet me qëllim të garantimit të sigurisë së materialeve zgjedhore dhe ruajtjes së integritetit të procesit të votimit dhe numërimit në vendvotim

**EPOKA E RE**

**Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 30 JANAR** - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) i ka blerë 2 500 kamera vëzhguuese, bashkë me pajisje përcjellëse, për ta monitoruar dhe vëzhguar procesin zgjedhor të 9 shkurtit. Në total kontrata ka kushtuar 699 mijë euro dhe atë e ka fituar kompania “Besa Security”. Kontrata është nënshkruar më 31.10.2024. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka thënë se kamerat do të vendosen brenda vendvotimit por, sipas tij, do të vendosen në atë mënyrë që do të garantojnë ruajtjen e integritetit të procesit të votimit dhe numërimit. “Vendosja e kamerave vëzhguuese në hapësirat brenda vendvotimit bëhet me qëllim të garantimit të sigurisë së materialeve zgjedhore dhe ruajtjes së integritetit të procesit të votimit dhe numërimit në vendvotim. Vendosja e kamerave në vendvotime do të bëhet duke siguruar plotësisht fshehtësinë e votës, pasi ato do

të vendosen në skajin tjetër të vendit ku do të jetë kabina e votimit dhe në asnjë rrethanë nuk do të mund ta regjistrojë shënjimin e preferencës së votuesit. Ruajtja e regjistrimeve të kamerave do të jetë e përkohshme deri në shkatërrimin e materialit zgjedhor, me përjashtim të atyre nga vendvotimet ku evidentohen parregullsi me qëllim që t’iu ofrohen institucioneve ligjzbatuese. Në ditën e zgjedhjeve KQZ-ja nuk do t’i monitorojë këto kamera, por do të bëhet në mënyrë pasive dhe se qasja në videoregjistrime mund të sigurohet vetëm me vendim apo kërkesë të institucioneve ligjzbatuese”, ka thënë Elezi.

**KQZ-ja emëron mbi 15 mijë komisionarë për zgjedhjet e 9 shkurtit**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mori vendim për emërimin e anëtarëve të 2 533 Këshillave të Vendvotimit në

kuadër të 903 Qendrave të Votimit në 38 komuna të Republikës së Kosovës të cilët do të angazhohen në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës më 9 shkurt 2025. Sipas vendimit të KQZ-së, numri i përgjithshëm i anëtarëve të emëruar, të cilët përfaqësojnë subjektet politike të certifikuara për pjesëmarrje në zgjedhje, është rreth 15 mijë, prej të cilëve më shumë se 12 mijë do të angazhohen në vendvotime të rregullta, ndërkafq më shumë se 200 në vendvotimet në të cilat do të zhvillohet votimi me kusht. KQZ-ja emëroi më shumë se 2 300 anëtarë që do të shërbejnë në grupet e numërimit të votave të kandidatëve për deputetë që do të zhvillohen në 38 Qendrat Komunale të Numërimit në të gjitha komunat e Kosovës. Sipas vendimit të KQZ-së, do të shqyrtohen dhe verifikohen rastet kur subjektet politike kanë nominuar persona nga komuniteti tjetër dhe ta bëjnë zëvendësimin e tyre. Po ashtu, KQZ emëroi edhe anëtarët e

Këshillave të Vendvotimit që do të angazhohen në 43 vendvotime në përfaqësi diplomatike në shtete të ndryshme në të cilat do të mbahet procesi i votimit më 8 shkurt 2025. Koalicioni i OJQ-ve Demokracia në Veprim (DnV) ka njoftuar lidhur me mbarëvajtjen e dy javëve të fushatës zgjedhore, mbulimin medial, gjuhën e urrejtjes dhe shpenzimet në rrjetet sociale. Sipas DnV-së, subjektet politike kanë vazhduar me intensitet të shtuar të aktiviteteve, në një ambient kryesisht të qetë, ndonëse shqetësues mbetet vazhdimi i përdorimit të gjuhës nxitëse dhe të urrejtjes në aktivitetet e mbajtura nga subjektet politike. Në tërësi gjatë dy javëve të para DnV ka monitoruar 377 tubime publike (160 në javën e parë, ndërsa 217 aktivitete të tjera në javën e dytë) të subjekteve politike, në të gjitha komunat e vendit, duke përfshirë edhe ato me shumicë serbe. Me numrin më të madh të aktiviteteve po vazhdon të prijë LDK-ja me 109 aktivitete, ndjekur nga PDK-ja me 106 aktivitete, LV-ja me 71 aktivitete, si dhe AAK-ja me 54 aktivitete. Aktivitete kanë mbajtur edhe subjektet e tjera si Lista për Familjen, si dhe subjektet e komuniteteve të tjera, si Lista Serbe, Za Slobodu Pravdu i Opstanak, Srpska

Demokratija, IRDK, PRBK etj. Subjektet politike i kanë koncentruar tubimet e tyre publike nëpër qendrat kryesore, përfshirë Prizrenin (45 aktivitete), Prishtinën (27 aktivitete), Pejën (23 aktivitete) dhe Gjilanin (22 aktivitete). Në nëntë palë zgjedhjet e mbajtura në Kosovë pas shpalljes së pavarësisë më 2008, kanë votuar më pak se 50 për qind e gjithsej votuesve të regjistruar. Por, jo të gjitha grupet - komunitetet etnike, gjinitë e grupmoshat - janë paraqitur në vendvotime në të njëjtën përqindje. Të dhënat e ndara për gjini tregojnë se burrat votojnë në përqindje më të lartë se gratë. Në të gjitha zgjedhjet, përveç zgjedhjeve lokale të vitit 2013, burrat në Kosovë kanë votuar në përqindje më të lartë sesa gratë. Në zgjedhjet e fundit parlamentare ky hendek është rritur në krahësim me zgjedhjet paraprake. Ndërkohë, janë të rinjtë ata që në ditën e zgjedhjeve drejtohen te vendvotimet në përqindjen më të lartë. Mbi 53 për qind e të rinjve që për herë të parë kishin mundësinë e votimit, e shfrytëzuan atë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021. Asnjë grupmoshë tjetër nuk kishte përqindje më të lartë të votimit, ndërsa në vendin e dytë ishte grupmosha nga 41 në 44 vjeç, me gati 49 për qind.

# Partitë me platforma ‘shkel e shko’ kundër dhunës në familje

PRISHTINË, 30 JANAR - Edhe pse një krizë në rritje në Kosovë, dhuna në familje është kryesisht e neglizhuar në platformat e partive politike që synojnë pushtetin në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit. Me premtime të paqarta dhe angazhime sipërfaqësore, analistët thonë se trajtimi real i situatës nuk duket në horizont.

Të dhënat që Radio Evropa e Lirë i siguroi nga Policia e Kosovës tregojnë se në vitin e kaluar numri i rasteve të raportuara të dhunës në familje ka shënuar ngritje në krahassim me vitin 2023.

Më 2024 kishte 2 959 raste, kurse më 2023, 2 460 raste. Në shumicën e tyre, viktimat janë gratë.

Nga viti 2010, ndërkaq, në Kosovë janë vrarë rreth 60 gra, dy prej tyre vitin e kaluar. Në të shumtën e rasteve autorë të këtyre krimeve kanë qenë bashkëshortët ose ish-bashkëshortët.

Nga viti 2010 deri në prill të vitit 2024 në Kosovë janë vrarë 58 gra. Organizatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në disa raste i kanë fajësuar autoritetet për dështim në mbrojtjen e grave të rrezikuara nga dhuna. Në të shumtën e rasteve, autorë të vrasjeve kanë qenë bashkëshortët, pastaj baballarët dhe djemtë.

REL-i kontaktoi disa kandidatë të partive kryesore në garë - Lëvizjes Vetëvendosje, Partisë Demokratike të Kosovës, Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës - për t'i pyetur rreth zotimeve që i kanë në programet zgjedhore për t'iu kundërvënë dhunës në familje, por asnjëri prej tyre nuk u përgjigj.

As në tubimet që mbajnë me qytetarë kjo temë nuk dominon.

## Çfarë thuhet në platformat zgjedhore të partive?

Lëvizja Vetëvendosje nuk ka të publikuar program të zgjeruar zgjedhor në formë të shkruar, por në shpalosjen e zotimeve të kësaj partie, udhëheqësi i saj, Albin Kurti, foli për çështje që prekin familjen, si: prona, trashëgimia, dhuna, divorci e alimentacioni. “Përgjigja jonë do të jetë themelimi i gjykatës për çështje familjare, e cila me prioritet dhe shpejtësi do t'i trajtojë rastet të cilat qytetarët i adresojnë në gjykata”, tha Kurti, pa dhënë hollësi të tjera.

Në dhjetor të vitit të kaluar ai njoftoi edhe për hyrjen në fuqi të monitorimit elektronik të kryesve të dhunës apo të dyshuarve, duke thënë se mbikëqyrja e tillë “do ta luftojë dhunën në familje si asnjëherë më parë”.

Në anën tjetër, Partia Demokratike e Kosovës në programin zgjedhor zotohet se do të zhvillojë një “qasje gjithëpërfshirëse” për ta luftuar dhunën ndaj grave. Sipas PDK-së, kjo synohet të bëhet “duke integruar njësi të specializuara policore, shërbime të përkushtuara mbështetëse, trajnime të synuara dhe fushata të ndërgjegjësimit publik, që sigurojnë përgjigje gjithëpërfshirëse dhe efektive për mbrojtjen dhe fuqizimin e grave në mbarë Kosovën”.

Partia tjetër, Lidhja Demokratike e Kosovës, e prek çështjen e dhunës në familje në kontekstin e zotimeve për fuqizimin e infrastrukturës policore. “Në këtë drejtim do të angazhohemi që viktimat e dhunës në familje të trajtohen në mënyrë të veçantë, përfshirë dhoma të ndara për intervistim”, thuhet në programin zgjedhor të LDK-së. Kjo parti parasheh, gjithashtu,

investimin e 2.5 milionë eurove në sistemin e kamerave në trup te policët që trajtojnë dhunën në familje.

Në programin e saj thuhet se do të ketë edhe Ministri të Familjes dhe Mirëqenies.

Kjo e fundit përmendet edhe në programin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Aty thuhet se përgjegjësi të kësaj ministrie do të jenë “hartimi dhe angazhimi multidisiplinar për një strategji gjithëpërfshirëse kundër dhunës në familje”.

Më konkretisht se si ose kur do të realizohen këto, nuk specifikohet në programin e asnjërës parti.

## “Me informata të gabuara”

Për Adelina Berishën, menaxhere e programit kundër dhunës me bazë gjinore në Rrjetin e Grave të Kosovës, qasja e partive politike ndaj dukurisë së dhunës në familje është vetëm “shkel e shko” apo “klishe”. “Ato as që e kanë marrë mundin të shohin se çfarë ekziston dhe çfarë duhet bërë... Për shembull, te PDK-ja thonë ‘një qasje gjithëpërfshirëse’ dhe ‘të integrohen njësitë e specializuara policore’.

Kjo është informatë e gabuar, sepse secili stacion policor e ka njësinë për trajtimin e dhunës në familje”, thotë Berisha për Radion Evropa e Lirë. Informata të tilla të gabuara, sipas saj, kanë edhe partitë e tjera. “Një prej ideve të LDK-së është ‘krijimi i dhomave të ndara për intervistim në stacionet policore’, gjë që tashmë ekziston në shumicën e stacioneve policore të Kosovës. Një gjë që ndodh në praktikë, ata e kanë futur në program”, thotë Berisha.

Vërejtje të ngjashme me të ka edhe Vebi Mujku nga Instituti për Zhvillimin e Politikave

Sociale. “Unë nuk kam parë program serioz ose qasje serioze te partitë politike në përgjithësi lidhur me trajtimin e dhunës në familje apo të të gjithë segmentit të mirëqenies sociale sepse dhuna në familje ndërlidhet edhe me divorcin, me alimentacionin, me besimin e fëmijëve dhe kontaktimin e tyre. Pra, janë disa pasoja shkakut i dhunës në familje”, thotë Mujku për Radion Evropa e Lirë.

## Çfarë duhet të bëjë qeveria e ardhshme?

Berisha thotë se përballja efikase me dukurinë e dhunës në familje duhet të nisë me parandalimin e rasteve të kësaj dhune.

Edukimi për barabarësinë ndërmjet gjinive, “jashtë normave patriarkale dhe sociale që mirëmbajnë dhunën në familje dhe gratë në pozita të rrezikshme”, duhet të nisë qysh në çerdhe, thotë ajo. Ndaj, shton Berisha, kushdo që merr pushtetin pas zgjedhjeve të 9 shkurtit, do të duhej t'i qasej fuqizimit të sistemit të arsimit, për të ndikuar në ndryshimin e normave sociale. Ajo konsideron se komunikimi i mirëfilltë ndërmjet ekzekutivit dhe sistemit gjyqësor e prokurorial ndihmon në luftimin e dukurisë së dhunës në familje. Sipas Berishës, të domosdoshëm janë edhe këta hapa: sigurimi i të gjithë mekanizmave për sistemin e mbrojtjes së viktimës, shtimi i stafit në qendrat për punë sociale dhe trajnimi i gjithë stafit lidhur me legjislacionin, ngritja e kapaciteteve dhe trajnimi i stafit në sistemin shëndetësor për identifikimin e viktimave të dhunës në familje. “Duhet shumë punë që dhuna të parandalohet, por edhe në rastet kur ndodh ajo, ne duhet t'i kemi në dispozicion të gjithë

mekanizmat që e mbrojnë viktimën”, thekson Berisha.

Për Mujkun, kushdo që qeveris vendin në të ardhmen, duhet të rregullojë një vijë vertikale të përgjegjësisë për këtë çështje. Sipas tij, një pjesë e shërbimeve sociale është në kompetencën e qendrave për punë sociale të nivelit komunal, ndërkohë që politikat i zhvillon niveli qendror. “Ky sistem duhet ta ketë vijën përgjegjëse, pra kush e merr hapin e parë, të dytë, të tretë... e jo të mbetet duke u hedhur faji nga një institucion në tjetrin”, thotë Mujku.

Institucionet e Kosovës në disa raste kanë shkëmbyer akuza mes vete. Në prill të vitit 2024, kur në Kosovë janë vrarë dy gra brenda pak ditësh, ministrja e Drejtësisë e Kosovës, Albulena Haxhiu, ka thënë se dhunuesit, shpeshherë, “bëhen vrasës” për shkak të “mosndëshkimit adekuat nga institucionet përkatëse”. “Kur dhunuesi e sheh që po ledhatohet nga sistemi, ai e përsërit veprën penale”, ka thënë atëkohë Haxhiu.

Vrasja e rëndë në Kosovë dënohet me minimum 10 vjet burgim dhe me maksimum burgim të përjetshëm. Për të akuzuarit për dhunë në familje, Kodi Penal i Kosovës parasheh dënime me gjobë dhe deri në tre vjet burgim. Por, në një raport që ka publikuar Grupi për Studime Juridike dhe Politike në Kosovë në vitin 2023, është thënë se shumë pak të akuzuar për veprën e tillë janë dënuar me burg - shumica me gjobë. Sipas përfaqësuesve të shoqërisë civile, numri i grave që përjetojnë dhunë në familje në Kosovë është shumë më i lartë se shifrat zyrtare. Ata thonë se dhuna nënraportohet për disa arsye, përfshirë: presionin social mbi gratë, mungesën e pavarësisë së tyre ekonomike dhe mostrashëgimin e pasurisë nga prindërit.



## FSK-ja, pjesë e ushtrimit ndërkombëtar "Combined Resolve 25"

PRISHTINË, 30 JANAR - Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) po merr pjesë me një kontingjent në ushtrimin ndërkombëtar "Combined Resolve 25", i cili po zhvillohet në bazën ushtarake amerikane në Hohenfels, Gjermani. Ky ushtrim ka për qëllim testimin dhe vlerësimin e gatishmërisë së njërive luftarake të NATO-s, si dhe përgatitjen e shteteve partnere për operacione të

përbashkëta dhe ndërveprim. FSK i është bashkuar ushtrimit me ftesën e Ushtrisë Amerikane, duke synuar ngritjen profesionale, forcimin e ndërveprimit me shtetet partnere dhe rritjen e gatishmërisë për të vepruar në një mjedis të kombinuar shumëkombësh. Gjithashtu, pjesëmarrja në "Combined Resolve 25" ofron mundësinë për shkëmbimin e

përvojave me forcat ushtarake të shteteve të NATO-s, dhe partnere pjesëmarrëse në ushtrim.

Ky angazhim pasqyron përkushtimin e FSK-së për të kontribuar në sigurinë dhe stabilitetin në nivel ndërkombëtar, si dhe për t'i avancuar aftësitë operacionale sipas standardeve më të larta ushtarake.



## Eurodeputetët: Qasja e pabalancuar e BE-së ka ndikuar negativisht në dialogun Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 30 JANAR - Eurodeputetët i kanë thënë emisarit në largim të Bashkimit Evropian, Miroslav Lajçak, se qasja e pabalancuar në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë ka ndikuar negativisht në këtë proces, thanë burimet e Radios Evropa e Lirë në Parlamentin Evropian. Lajçaku më 30 janar ka zhvilluar një takim lamtumirës me deputetët e Parlamentit Evropian në Komisionin për Politikë të Jashtme, me të cilët ka biseduar për mandatin e tij pesëvjeçar si i dërguari i bllokut për dialogun për normalizim të raporteve mes Kosovës dhe Serbisë.

Burime të Radios Evropa e Lirë thanë se gjatë këtij takimi, të zhvilluar me dyer të mbyllura, shumica e eurodeputetëve kanë qenë kritikë ndaj mënyrës se si BE-ja u është qasur palëve në dialog dhe në përgjithësi në raportet e shteteve me bllokut. Mësohet se gjatë këtij debati shumica e deputetëve të PE-së janë shprehur se masat ndëshkuese që BE-ja ka vendosur ndaj Kosovës dhe në të njëjtën kohë nuk ka pasur masa ndaj Serbisë, veçmas pas sulmit të armatosur në Banjskë më 2023, kanë ndikuar negativisht në dialogun që ndërmjetësohet nga BE-ja.

Në shtator të vitit 2023 një grup i serbëve të armatosur sulmoi Policinë e Kosovës në Banjskë të Zveçanit, duke vrarë një rreshter. Gjatë këmbimit të zjarrit u vranë edhe tre sulmues serbë.

Kosova ka fajësuar Serbinë për



sulmin, por Beogradi ka mohuar përfshirjen. Kosova kërkon ekstradimin e Millan Radoiçiqit - ish-politikanit dhe biznesmenit nga veriu i Kosovës që ka marrë përgjegjësinë për sulmin në Banjskë - nga Serbia, ku besohet se gjendet. BE-ja, por edhe Shtetet e Bashkuara kanë përsëritur thirrjen e tyre që përgjegjësit për sulmin të përballen me drejtësi.

Eurodeputetët, gjatë takimit me

Lajçakun, kanë kërkuar edhe një herë heqjen e masave - të vendosura ndaj Kosovës më 2023 për shkak të tensioneve në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe - dhe një qasje të balancuar nga ana e BE-së.

Zyrtarë të lartë në Kosovë, përfshirë presidenten Vjosa Osmani dhe kryeministrin Albin Kurti, disa herë e kishin kritikuar Lajçakun dhe ish-kryediplomatën e BE-së, Josep

Borrell, për njëanshmëri në dialog, njëkohësisht kanë kërkuar heqjen e masave ndëshkuese.

Sipas burimeve, mësohet se Lajçaku është pajtuar me konstatimin e eurodeputetëve se është dashur të hiqen masat ndaj Kosovës dhe ai kishte kërkuar një gjë të tillë menjëherë pas sulmit në Banjskë, por është arsyetuar se heqja e tyre nuk ishte në dorën

e tij, por vendim që iu përket vendeve anëtare.

Lajçaku e përfundon mandatin të premten, më 31 janar, e një ditë më pas nis mandati i emisarit të ri për dialogun, i diplomatit nga Danimarka, Peter Sorensen.

Lajçaku në takim me eurodeputetët mësohet se është shprehur që BE-ja duhet të mbajë rol kryesor në lehtësimin e dialogut dhe në përgjithësi angazhimin në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Gjatë mandatit pesëvjeçar të Lajçakut si ndërmjetës në dialog, palët kanë arritur Marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit të raporteve dhe Aneksit të zbatimit të arritur më 2023.

Lajçaku, siç mëson REL-i, në takimin me eurodeputetët ka pranuar se nuk ka pasur përparim që ai ka pritur sa i përket zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

Marrëveshja prej 11 nenesh, ndër të tjera, parasheh një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë, njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore që Serbia të mos bllokojë anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare, dhe kërkon nga Prishtina dhe Beogradi t'i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të arritura gjatë dialogut.

Palët janë pajtuar për marrëveshjen, por nuk e kanë nënshkruar atë. Megjithatë, BE-ja thotë se marrëveshja është ligjërisht e obligueshme për Kosovën dhe Serbinë.

## Kurti takon përfaqësues nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës

PRISHTINË, 30 JANAR - Mëngjesin e së enjtes, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, mirëpriti në takim përfaqësues nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, bashkë me Ministren e Drejtësisë, Albulena Haxhiu.

Së pari, kryeministri e përgëzoi Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës dhe aktivisten Feride Rushiti për suksesin e nominimit për Çmimin Nobel

për Paqe, nominim i cili u bë nga deputeti i Parlamentit suedez, Magnus Jacobsson. Kryeministri shprehu gatishmërinë për mbështetjen e pazezervë të Qeverisë së Republikës së Kosovës për këtë nominim.

Këtij urimi dhe gatishmërisë për përkrahje iu bashkua edhe ministrja Haxhiu, e cila theksoi se ky nominim vjen si pasojë e punës së madhe të organizatës dhe përfaqësuesve të saj për adresimin e dhunës seksuale

gjatë luftës në Kosovë, si dhe shtoi rëndësinë e vazhimit e fuqizimit të bashkëpunimit të Ministrisë së Drejtësisë me Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës.

Në vijim, kryeministri vlerësoi punën e çmueshme të QKRMT-së, duke veçuar rëndësinë e grumbullimit të bazës së të dhënave dhe dëshmimeve të të mbijetuarve të torturës e dhunës gjatë luftës në Kosovë.



# Osmani: Sulmet hibride përbëjnë sfida reale për stabilitetin kombëtar

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 JANAR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka bërë thirrje të enjten për forcim të kapaciteteve mbrojtëse të Kosovës, dhe ka vlerësuar se sulmet hibride përbëjnë sfida reale për stabilitetin kombëtar. Ajo i ka bërë këto deklarata në një konferencë të organizuar nga Ministria e Mbrojtjes me temën për qëndrueshmërinë kombëtare. “Sulmet hibride, që përfshijnë edhe operacione të kombinuara kibernetike, ushtarake, ekonomike dhe informative, më mirë të them dezinformative në këtë rast, janë sfida reale për stabilitetin tonë

kombëtar”, ka thënë Osmani, duke bërë thirrje për trajnim ekspertësh dhe bashkëpunim me partnerët strategjikë për ndërtim të kapaciteteve për të garantuar mbrojtje. “Zhvillimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës, sipas standardeve më të larta të NATO-s, mbetet prioriteti ynë strategjik e kombëtar”, ka thënë Osmani, duke përmendur se investimi në armatim, personel ushtarak dhe mirëqenien e tyre është jetik, ashtu sikurse investimi në institucione të tjera të sigurisë.

Ajo ka përmendur edhe sigurinë energjetike si shumë të rëndësishme për sigurinë kombëtare. “Shteti ynë duhet të investojë në përmirësim të

infrastrukturës kritike dhe zhvillimin e një ekonomie të qëndrueshme, me theks të veçantë në sigurinë energjetike dhe mbrojtjen e sistemeve të rëndësishme”.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se Kosova vazhdon t’i bashkërendojë të gjitha përpjekjet e saj në drejtim të anëtarësimit në NATO. “Ne nuk synojmë vetëm të përfitojmë nga aleancat, por edhe të kontribuojmë në to”.

Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka përmendur se, përveç qëndrueshmërisë ushtarake, në epokën e avancimit të teknologjisë, rezistenca kibernetike është parësore. “Sulmet kibernetike

nuk njohin kufij dhe mund t’i destabilizojnë qeveritë, ekonomitë dhe sistemet e infrastrukturës kritike. Ndërtimi i rrjeteve të sigurta dhe aftësia për rimëkëmbje të shpejtë duhet të jetë prioriteti i çdo strategjie”, ka thënë ai.

Zyrtarët e Kosovës përmendin vazhdimisht se synojnë anëtarësimin e vendit në NATO, ndonëse janë të vetëdijshëm se anëtarësimit në këtë aleancë veriatlantike duhet t’i paraprijë përfshirja e Kosovës në programin e aleancës, Partneriteti për Paqe.

Partneriteti për Paqe është një program i NATO-s që synon krijimin e besimit midis shteteve anëtare të NATO-s dhe shteteve

të tjera në Evropë.

Shtetet e Bashkuara kanë mbështetur anëtarësimin e Kosovës në këtë program, ndonëse kanë rikujtuar se për një vendim të tillë kërkohet pajtimi i të gjitha vendeve anëtare.

Forcat e NATO-s janë të pranishme në Kosovë qysh në qershor të vitit 1999, pas përfundimit të luftës dhe tërheqjes së forcave serbe.

Kosova kufizohet me tri shtete anëtare të NATO-s: Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut.

Në radhët e NATO-s janë katër shtete që ende nuk e njohin pavarësinë e Kosovës: Greqia, Spanja, Rumania dhe Sllovakia.



## Danimarkës po i vonohet burgu në Gjilan

PRISHTINË, 30 JANAR - Në shtator të vitit të kaluar ministri danez i drejtësisë, Peter Hummelgaard, erdhi në Kosovë për ta paraqitur projektin e tij prestigjioz. Ai qëndroi në Gjilan krah për krah me ministren e Drejtësisë të Kosovës, derisa inspektorin burgun ku do të strehoheshin 300 kriminelë të dëbuar nga Danimarka, si pjesë e zgjidhjes së qeverisë për mungesën e hapësirës në burgjet daneze.

Por një dokument i ri për Komisionin e Çështjeve Ligjore, të cilin media daneze “Avisen Danmark” e ka, tregon se projekti është shtyrë. “Mirëpo, ndërtimi dhe renovimi i burgut, i cili po kryhet nga Shërbimi

Korrektues në Kosovë, aktualisht po përballet me vonesa”, thuhet në dokument, transmeton Klankosova.tv.

ShKK i ka konfirmuar gjithashtu “Avisen Danmark” se projekti nuk po shkon sipas planit. “Shërbimi Korrektues i Kosovës mund të konfirmojë se projekti i ndërtimit në Kosovë aktualisht po përballet me vonesa”, thuhet në njoftim. Që Danimarka ta fillojë përdorimin e burgut, si ndërtesat ashtu edhe stafi duhet t’i përmbushin standardet daneze. Prandaj, qelitë duhet të rinovohen dhe të krijohen dhoma të reja për vizitorë. Megjithatë, puna ndikohet nga disa probleme.



ShKK ka thënë se ende nuk ka gjetur këshilltarët e nevojshëm teknikë të TI-së dhe sigurisë, si

dhe është vonuar edhe rekrutimi i ekspertëve teknikë të ndërtimit.

Gazeta daneze thotë se për këto arsye është e paqartë se kur mund të përdoret burgu. Deri më tani Shërbimi Korrektues i Kosovës ka kërkuar një afat të ri dhe po përpiket ta shkurtojë vonesën duke vënë në dispozicion këshilltarët e vet.

Ministri i drejtësisë Hummelgaard tha se nuk është i befashuar nga vonesa. “Ne po shkelim një terren krejtësisht të ri duke dërguar të huaj kriminelë të dënuar me deportim në Kosovë”, tha Hummelgaard në një përgjigje me shkrim.

Megjithatë, ai thekson se projekti mbetet prioriteti i lartë dhe se dialogu me Qeverinë e Kosovës po vazhdon.

## Edhe sllovenët bojkotojnë dyqanet shkak u i çmimeve të larta

LUBIANË, 30 JANAR - Në Slloveni disa qendra tregtare dhe supermarketet janë duke u bojkotuar nga qytetarët, e ky bojkot do të vazhdojë deri më 2 shkurt. Pas kësaj date, bojkotet do të zgjaten për t'u fokusuar në rrjetet e tjera tregtare nga 3 shkurti deri më 9 shkurt.

Ky bojkot shumëditor pason pas një bojkoti të ngjashëm të zhvilluar në Kroaci, ku një ditë bojkot shkaktoi rënie të ndjeshme të qarkullimit deri

në 50 për qind. Shoqata e Konsumatorëve e Sllovenisë e konsideron bojkotin një formë legjitime të protestës, duke theksuar se ai mund të dërgojë një mesazh të fortë për shitësit për rëndësinë e çmimeve të drejta dhe përbalueshmërisë, shkruajnë mediet.

Sipas statistikave të Sllovenisë, ushqimet kanë rritur çmimet mesatarisht me 44 për qind krahasuar me dhjetë vjet më parë, megjithatë rritja e

çmimeve është ngadalësuar vitin e fundit. Sidoqoftë, disa produkte, si vaji i ullirit, gjalpi, mishi dhe buka, kanë regjistruar rritje të çmimeve, përkatësisht nga 2 deri në 20 për qind. Bojkotet nuk janë të kufizuara vetëm në Slloveni. Në Kroaci një bojkot tjetër është planifikuar për këtë të premte, ndërsa thirrje të ngjashme për bojkot janë shfaqur në Bosnjë-Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi.



## Vetëm në dhjetor u regjistruan 943 ndërmarrje të reja

Prishtinë, 30 janar - Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), në dhjetor 2024, krahasuar me muajin nëntor 2024, kemi rënie për 2.6 % të ndërmarrjeve të regjistruara, ndërsa krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak, kemi rritje për 16.9 % të ndërmarrjeve të regjistruara. Në kategorinë “Mikro ndërmarrje”, që kanë 1 deri në 9 të punësuar, janë gjithsej 935 ndërmarrje të regjistruara, ndërkaq në kategorinë “Ndërmarrje të vogla” me 10 deri 49 të punësuar, janë gjithsej 7 ndërmarrje të regjistruara. E në kategorinë “Ndërmarrje të mesme” me 50 deri 249 të punësuar është vetëm 1 ndërmarrje e regjistruar,

kurse në kategorinë “Ndërmarrje të mëdha” nuk kemi ndërmarrje të regjistruara këtë muaj. Sa i përket shtrirjes gjeografike të ndërmarrjeve të regjistruara në nivel të regjioneve prin regjioni i Prishtinës me 496 ndërmarrje të regjistruara apo 52.6 %, regjioni i Prizrenit me 100 apo 10.6 %, regjioni i Ferizajt me 99 apo 10.5%, regjioni i Mitrovicës me 81 apo 8.6 %, regjioni i Gjilanit me 62 apo 6.6 %, rajoni i Gjakovës me 54, apo 5.7 % dhe rajoni i Pejës me 51 apo 5.4 %.


Por nuk pati vetëm ndërmarrje të regjistruara gjatë këtij muaji, pasi që gjatë dhjetorit të vitit 2024 janë shuar gjithsej 162 ndërmarrje. Rajoni me numrin më të



madh të bizneseve të shuara është Prishtina me gjithsej 66 biznese të shuara, pasuar nga Gjilani në të cilin gjatë muajit

dhjetor u shuan 23 ndërmarrje. Në Mitrovicë dhe Gjakovë gjatë dhjetorit u shuan nga 19 ndërmarrje. E

në Prizren gjatë dhjetorit u shuan 18 ndërmarrje, në Pejë 10 dhe në Ferizaj u shuan 7 ndërmarrje.



## Rruga Prizren - Tetovë, Aliu: Do të shkurtohet nga tri orë në më pak se një

Prishtinë, 30 janar - Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka zhvilluar një vizitë në punimet e rrugës Prizren - Tetovë. Aliu në rrjetin social “Facebook” ka bërë me dije se këtë vizitë e ka zhvilluar bashkë me zëvendësministrin Hysen Durmishi si dhe me

ministrin e Transportit, Aleksandar Nikoloski, dhe zëvendësministren e Transportit, Kaltrina Zekolli Shaqiri. Ai tha se ky projekt është i rëndësishëm, vlera e së cilës është mbi 33 milionë euro. “Ky projekt i rëndësishëm, me vlerë mbi 33 milionë euro dhe gjatësi prej 20 349 km, do ta

rrisë bashkëpunimin mes dy shteteve tona dhe do ta lehtësojë ndjeshëm lëvizjen e qytetarëve dhe mallrave. Pas përfundimit të rrugës, koha e udhëtimit do të shkurtohet nga tri orë në më pak se një orë, duke ofruar lidhje më të shpejtë dhe të sigurt përmes peizazhit mahnitës të maleve të Sharrit”, ka shkruar Aliu.

## Më 6 shkurt mbahet ankandi i radhës i letrave me vlerë prej 20 milionë eurosh

PRISHTINË, 30 JANAR - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka njoftuar se më 6 shkurt do të mbahet ankandi i parë për vitin 2025. Në këtë ankand do të emetohen obligacione me maturitet trevjeçar në shumën prej 20

milionë eurosh. Investimi në obligacione është investim i sigurt, i garantuar me Ligjin për Borxhin Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore, ku interesi i përcaktuar nga tregu ju garantohet për të gjithë kohëzgjatjen (3 vjet) dhe është tërësisht i

liruar nga tatimi. “Për detaje rreth pjesëmarrjes në ankande për blerjen e letrave me vlerë, ju lutem kontaktoni ndonjërin nga bankat komerciale që operojnë në Republikën e Kosovës”, thuhet në njoftim.



# A do ta fundosë apo shpëtojë zgjidhjen me dy shtete propozimi i Trumpit për Gazën?



Propozimi i presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, për t'i zhvendosur palestinezët nga Rripi i Gazës në vendet fqinje, është refuzuar dhe dënuar gjerësisht. Zhvendosja e detyrueshme e 2.3 milionë banorëve të Gazës drejt Egjiptit dhe Jordanisë mund të destabilizojë rajonin dhe të shkatërrojë çdo shans për një zgjidhje me dy shtete të konfliktit izraelito-palestinez, thonë ekspertët. Por, propozimi gjithashtu mund ta zhvendosë përgjegjësinë tek aleatët e SHBA-së në rajon për të dalë me një zgjidhje për një nga konfliktet më të ndërlikuar në botë, vlerësojnë njohësit. “Trumpi po merr pozicionin më ekstrem mbi një çështje jashtëzakonisht të ndjeshme si pjesë e një negociate më të gjerë për Gazën dhe Izraelin”, tha Sanam Vakil, drejtoreshë e Programit për Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut në institutin britanik të mendimit, Chatham House. “Duke vënë nën presion aleatët kyç të SHBA-së, të cilët janë realisht të varur nga ndihma dhe siguria amerikane, ai shpreson të arrijë qëllimin e tij për ndarjen e barrës”, tha Vakil. Uashingtoni ka mbështetur

për dekada një zgjidhje me dy shtete që do të krijonte një shtet të pavarur palestinez përkrah Izraelit. Por, progresi është penguar nga dallimet e thella mes izraelitëve dhe palestinezëve mbi kufijtë, vendbanimet dhe statusin e Jerusalemit. Palestinezët, gjithashtu, këmbëngulin që çdo shtet i ardhshëm palestinez duhet të përfshijë Rripin e Gazës, gjë që e bën propozimin e Trumpit shqetësues jo vetëm për kritikët, por edhe për aleatët e SHBA-së, përfshirë Gjermaninë. “Trump ende nuk ka artikulluar një vizion të qartë mbi zgjidhjen me dy shtete ose rrugën përpara në konfliktin Izrael-Palestinë, por nëse politika amerikane anon drejt zhvendosjes së palestinezëve nga Gaza, kjo sugjeron një hapësirë të kufizuar për përparim pozitiv në këtë çështje”, tha Gregory Brew, analist i lartë në grupin amerikan të analizave politike, Eurasia Group. Shumë nga banorët e Gazës janë zhvendosur dhe pjesa më e madhe e enklavës palestineze është shkatërruar pas luftës 15-mujore të Izraelit kundër Hamasit, grupit të shpallur organizatë terroriste nga SHBA-ja dhe

BE-ja. Konflikti u shkaktua nga një sulm i paprecedent i Hamasit në Izrael në tetor 2023. Luftimet u pezulluan për gjashtë javë si pjesë e një marrëveshjeje armëpushimi prej disa fazash të arritur më 15 janar, që parashikon një fund të përhershëm të luftës dhe rindërtimin e Gazës. Trump, i cili publikoi idenë e tij më 25 janar, tha se zhvendosja e mundshme e banorëve të Gazës “mund të jetë e përkohshme, mund të jetë afatgjatë.” Eldad Shavit, studiues i lartë në Institutin për Studime të Sigurisë Kombëtare në Tel Aviv, tha se e djathta ekstreme izraelite mbështet gjerësisht zhvendosjen e palestinezëve nga Gaza, sepse beson se “Izraeli mund ta pushtojë territorin dhe të ndërtojë vendbanime të reja.” Trump ka deklaruar se ka ndarë idetë e tij me Jordaninë dhe Egjiptin, aleatë të SHBA-së në rajon që marrin ndihma të konsiderueshme. Por, të dyja vendet janë kundër çdo përpjekjeje për të detyruar zhvendosjen e civilëve. Shavit tha se “nuk është e arsyeshme” të pritët që Jordania dhe Egjipti ta pranojnë këtë propozim, sepse ata tashmë strehojnë

miliona palestinezë të zhvendosur nga krijimi i Izraelit më 1948 dhe konflikti arabo-izraelit më 1967. Ai argumentoi se një pranim i mëtejshëm i refugjatëve “do të ishte një rrezik i madh për stabilitetin e këtyre vendeve”. Ekspertët thonë se zhvendosja e banorëve të Gazës dhe, për rrjedhojë, shkatërrimi i perspektivës për një shtet të pavarur palestinez, mund të pengojë gjithashtu përpjekjet për të normalizuar marrëdhëniet mes Izraelit dhe fuqisë rajonale, Arabisë Saudite. “Nuk e shoh si diçka që do të pritët pozitivisht në Gjirin Persik, veçanërisht në Arabinë Saudite, ku [Princi i Kurorës Mohamed bin Salman] e ka bërë krijimin e një shteti palestinez një kusht për normalizimin e marrëdhënieve me Izraelin”, tha Brew. Disa shtete arabe kanë normalizuar marrëdhëniet me Izraelin në kuadër të Marrëveshjeve të Abrahamit të ndërmjetësuar nga SHBA-ja vitet e fundit. Kundërshtimi i fortë ndaj planit të Trumpit mes aleatëve të Uashingtonit dhe shteteve arabe dëshmon se realizimi i tij është i pamundur, thonë ekspertët.

“Mendoj se duhet të jemi të kujdesshëm të mos lexojmë shumë në komentet e Trumpit, të cilat u bënë në një mënyrë të improvizuar”, argumentoi Brew. Trumpit i pëlqen të “mendojë në mënyrë të madhe” dhe ai dhe këshilltarët e tij mund të përpiqen të “ndryshojnë status quo-në” duke i shtyrë palët në rajon të marrin përgjegjësi për zgjidhjen e konfliktit izraelito-palestinez, tha Shavit. “Ai dëshiron t'i lëkundë palët në një mënyrë që t'i detyrojë të mendojnë për një zgjidhje që mund ta pranojnë”, tha ai. Trump prej kohësh ka kritikuar angazhimet e gjata ushtarake të SHBA-së dhe ka mbrojtur reduktimin e angazhimeve financiare amerikane jashtë vendit. Gjatë fjalimit të tij inaugures më 20 janar, ai e përshkroi veten si një “paqebërës”. “Trump dëshiron një Lindje të Mesme të re; ai dëshiron që sauditët t'u bashkohen Marrëveshjeve të Abrahamit dhe dëshiron të shihet si dikush që solli paqe dhe mori një Çmim Nobel për këtë”, tha Shavit./REL



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Kosova luan sot ndeshjen e rëndësishme ndaj Francës në futsall

Përfaqësuesja e Kosovës në futsall do të luajë sot (e premte) ndaj Francës në ndeshjen kualifikuese për “Euro 2026”. “Dardanët” janë

grumbulluar para disa ditësh për ndeshjen e rëndësishme kualifikuese që do të zhvillohet më 31 janar kundër Francës në Prishtinë. Përzgjedhësi Agon

Ramadani ka punuar këto ditë me futbollistët e ftuar dhe pret të zhvillojë një ndeshje të madhe ndaj një kundërshtari të fortë. Kosova ka

grumbulluar tri pikë në dy ndeshjet e para, me një fitore ndaj Bullgarisë dhe një humbje ndaj Gjeorgjisë në udhëtim, ndërsa Franca ka 6

pikë nga dy ndeshjet. Ky takim do të zhvillohet në “Pallatin e Rinisë dhe Sporteve” në Prishtinë, me fillim nga ora 20:00.

# Alketa Rama po jetëson ëndrrën e babait në futboll

Cyrih, 30 janar - Futbollisti i parë shqiptar që luajti për Zvicrën, Milaim Rama, ka publikuar një foto me vajzën, Alketa Rama, e cila luan për Kosovën, duke e përmbushur zemrën e babait të saj, i cili e kishte kryer karrierën pa e realizuar ëndrrën për të luajtur për vendin e tij të lindjes, transmeton albinfo.ch.

Padyshim se kjo histori ishte tërheqëse edhe për mediet zvicerane. Gazeta “Blick” e ka publikuar një artikull lidhur me Milaim dhe Alketa Ramën. Alketa, 21 vjeçe, është pjesë e skuadrës së femrave të FC Zurich që nga vera e kaluar. “Tani jam më krenarë për karrierën e saj sesa për timen”, thotë Milaimi. Ashtu si babai, Alketa jo vetëm që ka arritur në ligën më të lartë zvicerane, por është bërë lojtare kombëtare. Në shtator të vitit 2022 ajo bëri debutimin e saj në kualifikueset e Kupës së Botës për Kosovën. “Fatkeqësisht, babai im nuk pati mundësinë të luante për vendin e tij. Prandaj mendova të bëja të kundërtën dhe të përpiqesha ta bëja atë krenar”, thotë Alketa.

Alketa kishte luajtur më parë ndeshje ndërkombëtare për të rinjtë për Zvicrën. Para debutimit të saj për Kosovën, ajo ishte e vetëdijshme se “nëse luaj tani, nuk do të ketë kthim prapa”. Por ajo kurrë nuk u pendua për vendimin e saj. “Ndeshja ime e parë ishte shumë emocionuese. Ishte një ndjenjë shumë e veçantë të vishja këtë fanellë për herë të parë dhe më bëri shumë krenare”, kujton Alketa. Babai i saj pati një rrugë tjetër. Gjithçka nisi kur si 17-vjeçar u largua nga Kosova për në Zvicër, duke filluar nga FC Interlaken në ligën e 5-të. Prej

aty, si i talentuar hap pas hapi arriti që në moshën 21-vjeçare të luante në NATI B me FC Thun. Ky ishte fillimi i një rrëfimi të suksesshëm: kalimi në Nati A dhe pjesëmarrja në Kampionatin Evropian. Milaimi ka hapur rrugë për lojtarët kosovarë të tjerë të kombëtares si Xherdan Shaqiri, Granit Xhaka dhe Andi Zeqiri. “Thirrja ime e parë për kombëtaren shkaktoi një shpërthim në Kosovë”, thotë Milaimi. “Njerëzit ende flasin për atë moment, kur isha shqiptari i parë i Kosovës që arriti në një kampionat evropian”. Milaimi ndien një lidhje të fortë midis Zvicrës dhe Kosovës për sa i përket futbollit. “Kur luan Zvicra, të gjithë në Kosovë janë për të, përveç kur luan kundër Kosovës ose Shqipërisë!”.

Alketa përjeton shpesh statusin që babai i saj ka ende në Kosovë kur viziton vendlindjen. “Njerëzit janë shumë krenarë për atë që ka arritur babai im”, thotë ajo. Dikur njihej si vajza e Milaimit, por tani po perceptohet gjithnjë e më shumë si një futbolliste e talentuar

### Mjekët këshillonin fundin e karrierës për Alketën

Megjithatë, një vit e gjysmë më parë karriera e Alketës ishte në rrezik. Në gusht 2023 ajo pësoi një hernie diskale dhe këmba e saj e majtë u paralizua papritur. “Për një moment mendova se ëndrra ime kishte përfunduar”, thotë ajo. Mjekët e këshilluan ta ndërpriste karrierën. “Nuk pashë më dritë në fund të tunelit”, shprehet futbollistja. Megjithatë, Alketa qëndroi e fortë. Pasi kaloi një periudhë të gjatë rehabilitimi



me fizioterapi dhe injeksione, arriti të kthehej në fushë. “Ne festuam edhe suksese të vogla, si kur Alketa mundi të ecte sërish pa simptoma”, thotë Milaimi. Për të kalvari i vajzës ishte i dhembshëm. “Nëse thyeni një ligament, keni mundësinë të riktheheni pas disa muajsh, por një dëmtim shpine në këtë moshë është krejtësisht ndryshe”, shton ai.

### Rikthimi në fushë kundër Thunit

Gëzimi ishte i madh kur Alketa u rikthye në fushë në ndeshjen e parë të sezonit kundër Thunit në gusht të vitit të kaluar. Dhe rikthimi i saj nuk mund të shkonte më mirë: Pas hyrjes si

zëvendësuese, ajo shënoi një gol dhe ndihmoi me një asist. “Ishte një ndjenjë e shkëlqyer, një peshë e rëndë më u hoq nga zemra”, thotë Milaimi. Që nga ajo ndeshje Alketa ka arritur disa rezultate të tjera të shkëlqyera, përfshirë një gol për fitoren 2:1 kundër Baselit, përpara 3 000 tifozëve në St. Jakob Park, përfshirë familjen e saj me gjyshërit. Milaimi e përshkruan atë çast si një kujtim të paharrueshëm. “Ky është një moment që nuk do ta harrojmë kurrë”.

Një gol në Joggeli? Ky është një objektiv që Alketa e ka arritur, duke kaluar babanë në një aspekt të karrierës. Milaimi ka shënuar gjithsej 54 gola në Superligë, por nuk ka shënuar asnjëherë në St. Jakob-Park.

“Ajo godet më shpesh nga distanca”, thotë Milaimi, por Alketa dëshiron të mësojë nga babai i saj për teknikën e lojës me kokë. “Dua të jem po aq efikase para portës sa ai”, thotë ajo.

Në fund, edhe pse ka shënuar dy gola në sezonin e saj të parë në AWSL, Alketa e di se ka ende shumë për të arritur. “Sigurisht që dua të luaj më shumë dhe të shënoj më shumë, por pas lëndimit nuk po e shtyj shumë veten”, ka përfunduar ajo. Babai i saj tregoi se gjithçka është e mundur, edhe një lulëzim i vonë në futboll. Milaimi debutoi në Superligë kur ishte 26 vjeç, e ky ishte fillimi i një karriere të pasur, që e ka mbushur komodinën e dhomës së ndenjes me trofe.

## Ballkani transferon Valentin Sereben

Skuadra kampione në fuqi në elitën e futbollit të Kosovës, Ballkani, ka realizuar dy transferime në 24 orët e fundit. Kampionët nga Suhareka e transferuan të mërkurën portierin Artan

Iljazi, derisa të shtunën sulmuesim Valentin Serebe. Gardiani nga Kumanova ka qenë pjesë e skuadrave të njohura shqiptare në Maqedoni të Veriut, si FC Shkupi e KF Shkëndija.

Klubi i uron mirëseardhje Artanit, duke i dëshiruar suksese në arritjen e objektivave. “Me kënaqësi ju njoftojmë se sulmuesi Valentin Serebe i është bashkuar ekipit tonë në

formë huazimi nga skuadra e njohur rumune, CFR Cluj. Serebe vjen te Ballkani si një përforcim i rëndësishëm për repartin ofensivë, duke sjellë me vete eksperiencë dhe cilësi

të dëshmuara në sulm. Jemi të bindur se me talentin dhe përkushtimin e tij, ai do të ndihmojë ekipin në arritjen e objektivave tona këtë sezon”, thuhet në njoftim e Ballkanit.

## Niko Kovaq emërohet trajner i Dortmundit

DORTMUND, 30 JANAR - Trajneri kroat Niko Kovaq është trajner i ri i Borussia Dortmundit për ta zënë vendin e të shkarkuarit Nuri Sahin. 53-vjeçari është zyrtarizuar kryetrajner i skuadrës së Dortmundit. Palët kanë arritur një marrëveshje për një

kontratë që zgjat deri në vitin 2026. Kovaqi ka një përvojë të pasur në futbollin evropian. Më parë ai ka drejtuar klube të njohura si Eintracht Frankfurt, Bayern Munich dhe Monaco. Klubi i tij më i fundit ishte Wolfsburg, ku ai ka treguar aftësi të mira

menaxhuese. Me Dortmundin, Kovaqi do të përballlet me sfidën e rivendosjes së skuadrës në një nivel konkurrues, duke u përpjekur ta kthejë ekipin në një kandidat të fortë për garat evropiane pasi, sa i përket titullit, duket e pamundur që verdhezinjtë

të luftojnë. Tifozët e Dortmundit shpresojnë që përvoja dhe qasja e Kovaqit të sjellë stabilitet dhe sukses në të ardhmen e klubit. Ky emërim vjen në një kohë kur Dortmundi po kërkon një fillim të ri pas një sezoni me ulje ngritje, dhe Kovaqi duket të jetë



figura ideale për ta udhëhequr këtë tranzicion.

## Si do të funksionojë shorti i Ligës së Kampionëve?

NYON, 30 JANAR - Faza grupore e Ligës së Kampionëve 2024/25 ka përfunduar sipas formatit të ri të UEFA-s, i cili për herë të parë përdori sistem të ngjashëm me "Swiss League". Në këtë sistem, 36 ekipe luajtën secila nga tetë ndeshje kundër kundërshtarëve të ndryshëm, pa ndarje në grupe. Pas përfundimit të kësaj faze, tetë ekipet më të mira kaluan automatikisht në raundin e 1/8ës, ndërsa ekipet e renditura nga vendi i nëntë deri në të 24-tin do të luajnë në plejof për të siguruar vend në fazën tjetër të eliminimit direkt. Ekipet që kaluan direkt në raundin e 1/8-s janë: Liverpool, Barcelona, Arsenal, Inter, Atletico Madrid, Bayer Leverkusen, Lille dhe Aston Villa. Ndërkohë, ekipet që do të luajnë në fazën e plejofit janë: Atalanta, Borussia Dortmund, Real Madrid, Bayern, Milan, PSV, PSG, Benfica, Monaco, Brest, Feyenoord, Juventus, Celtic, Manchester City, Sporting dhe



Club Brugge. Shorti për fazën e plejofit do të hidhet më 31 janar (sot) në Nyon. Do të ketë sistem të veçantë shorti ku ekipet e renditura në vendet 9-16 do të përballen me ekipet e renditura në vendet 17-24. Një nga përballjet më interesante pritet të jetë ajo në mes të Real Madridit ose Bayern Munichut ndaj Manchester Cityt ose Celticut. Ndeshjet e para të plejofit do të zhvillohen më 11 dhe 12 shkurt, ndërsa ndeshjet e kthimit më 18 dhe 19 shkurt. Raundi i 1/8-s do të luhet më 4-5 dhe 11-12 mars.

### PËRBALLJET E PLEJOFIT:

Monaco dhe Bresti do të luajnë me njëri nga PSG-ja dhe Benfica (fituesit do të përballen me Liverpoolin respektivisht Barcelonën \*përcaktohet me short)

Sporting dhe Club Brugge do të luajnë me njëri nga Atalanta dhe Borussia Dortmund (fituesit do të përballen me Lille respektivisht Aston Villën \*përcaktohet me short)

Celtic dhe Manchester City do të luajnë me njëri nga Real Madridi dhe Bayerni (fituesit do të përballen me Atletico Madrid respektivisht Bayer Leverkusenin \*përcaktohet me short)

Feyenoord dhe Juventus do të luajnë me njëri nga Milan dhe PSV-ja (fituesit do të përballen me Arsenalin respektivisht Interin \*përcaktohet me short)

## Mitchelli udhëheq Cavaliersin drejt suksesit të radhës, fiton edhe Dallasi



MIAMI, 30 JANAR - Kryesuesit e Cleveland Cavaliersit fituan 126-106 në fushën e Miamit, në një ndeshje pa shumë histori. Donovan Mitchell me 34 pikë ishte lider për Cavaliersin. Fitoi edhe skuadra kampione e Bostonit, që falë 34 pikëve të

Porziongisit, mundi me rezultat 122-100 Chicagon. Fitore të rëndësishme korri ekipi i Golden States, që mundi me rezultat 116-109 Oklahoman, kryesuesen e Konferencës së Perëndimit. Alexander Shai realizoi 52 pikë për Oklahoman, por që

s'mjaftuan, ndërkohë që 48 pikë erdhën nga lojtarët e stolit të Golden States. Pas një loje spektakolare, ekipi i Dallasit fitoi me rezultat 137-136 ndaj New Orleansit. Katër lojtarë të Dallasit realizuan mbi 20 pikë. Zhgënjëu ekipi i Denverit, që u mund me rezultat 122-112 nga New Yorku, ku vendimtar ishte Jalen Brunson me 30 pikë.

### REZULTATET

|                           |         |
|---------------------------|---------|
| Charlotte - Brooklyn      | 83-104  |
| Indiana - Detroit         | 133-119 |
| Washington - Toronto      | 82-106  |
| Boston - Chicago          | 122-100 |
| Miami - Cleveland         | 106-126 |
| New York - Denver         | 122-112 |
| Philadelphia - Sacramento | 117-104 |
| New Orleans - Dallas      | 136-137 |
| San Antonio - Clippers    | 116-128 |
| Phoenix - Minnesota       | 113-121 |
| Golden State - Oklahoma   | 116-109 |

### SHKURT

#### Formacioni i javës në Ligën e Kampionëve

Tashmë është kompletuar faza e ligës në Ligën e Kampionëve, ndërsa janë përcaktuar tetë skuadrat e para që janë kualifikuar në të tetën e finales. Tetë të tjera do të shkojnë tutje përmes fazës "play-off". E tash pasi u mbyll faza e ligës, është koha për t'i bërë llogaritë. Faqja e specializuar për nxjerrjen e statistikave dhe për vlerësimin e futbollistëve "Sofascore" e ka publikuar formacionin më të mirë të xhiros së tetë në Ligën e Kampionëve. Formacioni: Takaç, Vazquez, Kimmich, Stones, Grimaldo, Olise, Rogers, Sahraoui, Dembele, Martinez, Rodrygo.

#### Hamiltoni shkatërron makinën pas një aksidenti në teste

Në ditën e tij të tretë në timonin e një Ferrari, Lewis Hamiltoni pati aksidentin e tij të parë. Gjatë kohës së pilotimit të tij në ditën e dytë të testeve në Barcelonë, 7 herë kampioni i botës në Formula 1 humbi kontrollin e makinës SF-23 në pistën e Montmelos. Një aksident pa pasoja për Sir Lewisin, por mësohet se ka pasur dëme të konsiderueshme në njëvendëshen e britanikut për sa i përket pjesës aerodinamike. Shkaqet e mundshme të aksidentit nuk janë dhënë, por dyshohet për një gabim gjatë frenimit. Pas debutimit një javë më parë në Fiorano, këtë herë në Barcelonë, Lewis Hamiltoni është angazhuar në një test më të thelluar që përfshin edhe mundësinë e kërimit të performancës. Ngjarja e paparashikuar komprometoi në mënyrë të pashmangshme dhe anuloi planin e punës për seancën e pasdites, i rezervuar për Charles Leclerc. Inxhinierët po sistemojnë makinën për testet e radhës.

#### Guardiola: Vështirë t'i shkojmë Bayernit ose Realit

Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, ka folur për përballjen e mundshme të ekipit të tij në fazën e eliminimit me dy nga skuadrat më të mira në botë. Rugëtimi i Cityt nuk ka qenë i lehtë në fazën e parë të Ligës së Kampionëve 2024/25, pasi përfundoi në vendin 22-të, një pozitë që e detyron të luajë ndeshjet "play-off" për ta siguruar kalimin në 1/8-tën. Kjo situatë e ka bërë detyrën e tij edhe më të vështirë, pasi tani do të përballlet me një nga dy skuadrat më të forta në Evropë, Real Madridin ose Bayern Munichun, për një vend në fazën tjetër të turneut më të rëndësishëm të klubeve. Guardiola e pranoi se skuadra e tij do të përballlet me një detyrë shumë të vështirë për të kaluar në fazën tjetër. "Ti shkojmë Bayern Munichut ose Real Madridit do të jetë shumë e vështirë, por pas dy javësh dhe brenda dy javësh do të na rikthehen disa lojtarë, përfshirë edhe përforcimet e reja, kështu që shpresojmë të bëjmë dy ndeshje të mira", ka thënë Guardiola.

## Anelotti: Nuk më pëlqen formati i ri i Ligës së Kampionëve

Real Madridi e ka mbyllur me fitore fazën e Ligës në Ligën e Kampionëve pasi ka triumfuar në udhëtim te Bresti me rezultat 0-3. Carlo

Anelotti ka folur për kundërshtarin e radhës të Realit që mund të jetë Manchester City. "Nëse luajmë kundër Cityt do të jetë

më e vështirë. Tani presim shortin", ka thënë Anelotti. "Nuk na pëlqen të luajmë kundër Manchester Cityt. Epo, City ka më shumë shanse për

ta fituar Ligën e Kampionëve", ka shtuar trajneri i Realit. Anelotti vazhdoi të ankohej për formatin e ri të Ligës së Kampionëve. "Nuk më pëlqen

ky format i ri. Janë luajtur shumë ndeshje. Ne duhet të heqim ndeshje, jo të shtojmë më shumë", ka deklaruar Anelotti.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "PASTRIMI" SH.A

Duke u bazuar në Ligjin Nr. Ligjin Nr. 03/L-212 i Punës konkretisht Neni 8 Udhëzimin Administrativ MFPT Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik konkretisht Neni 5 Paragrafi 1,2 dhe Neni 7, Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM "Pastrimi" SH.A, Vendimin e datës 29.01.2025 me numër të protokollit 02/01/56 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM "Pastrimi" SH.A, shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK  
( Për plotësimin e vendit të punës)

**Titulli i vendit të Punës:** "Udhëheqës për Shitje në Bizneset të Vogla dhe të Mesme" në KRM "Pastrimi" SH.A (1) pozitë;

**Departamenti:** Drejtoria për shitje për biznese;

**Numri i Referencës:** DSHB/KJ-01/2025;

**Koeficienti/Paga mujore:** Niveli XI;

**Kohëzgjatja e Kontratës së Punës:** Me kohë të pa caktuar.

**Periudha Provuere:** 3 muaj

1. Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Identifikimi dhe negocimi i bizneseve të cilat mund të jenë potenciale për të lidhur marrëveshje bashkëpunimi lidhur me mbledhjen e mbeturinave dhe politikave tjera që bien nën domenin e kompanisë;
- Hartimi i ofrave për bizneset potencialisht të mundshme për marrëveshje lidhur me mbledhjen e mbeturinave;
- Kontaktimi i kompanive potencialisht të mundshme për bashkëpunim dhe prezantimi i ofertës nga kompania;
- Në bashkëpunim em udhëheqësin dhe në koordinim me menagjimentin negocion çmimin dhe kushtet e ofrtave të prezantuara;
- Harton draft kontratën dhe pranon propozimet konkrete nga pala potencialisht e mundshme për kontraktim;
- Hartimi i draft marrëveshjeve për shërbimin e ofruar nga kompania;
- Identifikimi i mundësisë për nisma të reja dhe potenciale për të rritur numrin e bizneseve dhe kompanive që bashkëpunojnë me kompaninë lidhur me mbledhjen e mbeturinave;
- Kryen punë dhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës, të cilat kërkohen nga mbikëqyrësi;
- Për punën e tij i raporton Drejtorit për shtije për biznese.

2. Kriteret e përgjithshme për pranim në detyrë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën;
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në këtë ligj.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimimi i kërkuar:** Diplomë Universitare në Fakultetin Juridik apo Ekonomik;
- Përvoja e punës e kërkuar:** 2 vite përvojë pune profesionale.

4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- Aplikacioni i plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati;
- Kopje të diplomave të dhëna nga Institucionet Arsimore;
- Kopje të dëshmisë së punësimit ( Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës);
- Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve;

- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit, (e dëshirushme);
- Kopje të letërnjoftimit;
- Vërtetimin që nuk është i dënuar për kryerjen e një veprës penale jo më të vjetër se 3 muaj.

6. Mënyra e aplikimit në konkurs:

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në Zyret e Burimeve Njerëzore në KRM "Pastrimi" SH.A.  
Të gjitha aplikimet duhet të bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet platformës elektronike: [punesimi.krmpastrimi@gmail.com](mailto:punesimi.krmpastrimi@gmail.com)

7. Data dhe ora e saktë e përmbylljes së Konkursit Publik:

Konkursi publik zgjatë 15 ditë nga data: 30.01.2025 deri me datën 14.02.2025 Koha e fundit e pranimit të aplikimeve është ora 16:00,

Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

8. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit:

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të CV-së, testit me shkrim dhe me intervistim (test verbal).

- CV-ja e kandidatit vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë;
- Testi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë;
- Intervista (testi me gojë) vlerësohet deri në njëzetë (20) pikë.

Procedura e vlerësimit përmban gjithësejt njëqind (100) pikë, ku kalushmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët:

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimin elektronit dhe individualisht.

10. Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

Konkursi është i hapur deri me datën 14.02.2025.

Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri 7 ditë;

Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit;

Faza e Intervistes deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim;

Publikimi i rezultateve deri 5 ditë pas vlerësimit të intervistë.

**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ilir Zymeraj nga Petkoviq KK Rahovec shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "Rilindja" në Qifllak KK Rahovec lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Vesa Xhepa nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10,11,12 si dhe diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë. - Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz.

- Atdhe Mustafa nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme "Kadri Kusari" Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328. - Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

**RC**  
cola

# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

## Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA  
Since 1906

Columbus, Georgia, USA  
Since 1906 0.5L